



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E KULTURËS  
KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 349 Prot.

Tiranë, më 13.03 2019

**VENDIM Nr. 47, datë 06.03.2019**

Në mbështetje të *Ligjit Nr. 27/2018 "Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë"*, VKM Nr. 280, datë 01.04.2015 "Për përcaktimin e kriterëve, procedurave të dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi në ndërtimet me leje". Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr.2 të datës 06.03.2019, pasi shqyrtoi kërkesën e ALUIZNI-it Durrës për konfirmim nga KKA, për vijimin e procedurës së legalizimit të objektit "*Godinë e kombinuar 5 kate*" të *Z. Riza Zaim Lekli, Zona Kadastrale 8513, i cili pozicionohet brenda zonës arkeologjike "B" të qytetit të Durrësit,*

**VENDOSI:**

1. Të miratojë kërkesën e ALUIZNI-it Durrës për konfirmim nga KKA, për vijimin e procedurës së legalizimit të objektit "*Godinë e kombinuar 5 kate*" të *Z. Riza Zaim Lekli, Zona Kadastrale 8513, i cili pozicionohet brenda zonës arkeologjike "B" të qytetit të Durrësit.*
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
3. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

**KRYETAR  
ELVA MARGARITI  
MINISTËR**



**SEKRETAR I KKA  
RUDINA ZOTO**